



Rregullat e Ndhmës së Parë

I. Hyrje

Gjatë qëndrimit të nxënësve në shkollë, i gjithë stafi i shkollës duhet ta ketë parasysh sigurinë dhe mirëqenien e nxënësve. Ka rëndësi të veçantë që personeli i shkollës të jetë syhapur në rastet kur rrezikohet shëndeti i fëmijëve. Në të gjitha rastet kur nxënësit kanë probleme shëndetësore, menjëherë duhet lajmëruar infermieri / mjeku që është në shkollë. Infermieri / Mjeku pastaj e ka përgjegjësinë për ta trajtuar rastin në shkollë apo, në rast se konstaton që rasti është më serioz, atëherë ta dërgoj nxënësin në spital. Në rastet serioze, duhet menjëherë të njoftohet drejtori i shkollës.

II. Kutitë e Ndhmës së Parë

Të gjitha kutitë e Ndhmës së Parë janë tërësisht të pajisura dhe gjenden brenda objektit të shkollës, respektivisht nëpër klasa, laboratore, korridor dhe në sallën e edukatës fizike.

Veprimet të cilat duhet të ndërmerren në rastet e përgjithshme, janë si më poshtë:

- **Në raste të aksidenteve që rrezikojnë jetën ose në rast të sëmundjeve** – Urgjentisht duhet të lajmërohet mjeku i shkollës. Duhet të thirret emergjenca. Të lajmërohen prindërit. Infermieri / Mjeku i shkollës duhet ta ofrojë ndihmën e parë dhe ta shoqërojë nxënësin për në spital
- **Në raste të thyerjeve, lëndimit të gjunjëve, lëndimit të muskujve apo lëndimit të kokës** – Nxënësi duhet të paraqitet menjëherë të mjeku i shkollës, i cili e konstaton nëse nxënësi duhet të trajtohet në ordinancën e shkollës apo të dërgohet në spital. Në rast se nxënësi dërgohet në spital, atëherë duhet të lajmërohen prindërit menjëherë. Infermieri / Mjeku i shkollës duhet të qëndrojë me nxënësin në spital deri sa të arrijnë prindërit / kujdestarët e tij / saj, ose deri sa të përfundojë trajtimi dhe lirimi nga spitali.



- **Në raste të sëmundjes** – Çdo nxënës që nuk ndihet mirë me shëndet apo kur mësimdhënësi e vëren që nxënësi ka ndonjë problem shëndetësor, atëherë menjëherë duhet ta thërrasë infermierin / mjekun e shkollës. Në rast se infermieri / mjeku konstaton që nxënësi duhet të shkojë në shtëpi, atëhere prindërit / kujdestarët duhet të lajmërohen menjëherë nga sekretaria e shkollës / mësimdhënësi i klasës. Nxënësve u ndalohe t'i kontaktojnë prindërit drejtpërdrejtë lidhur me sëmundjen e tyre.
- **Në raste kur zbulohen morrat te fëmijët** – Në këto raste duhet të lajmërohen prindërit dhe të ju kërkohet atyre që t'i marrin fëmijët në shtëpi deri në trajtimin e plotë të gjendjes së tyre.

III. Ilaçet

Nxënësve u lejohe të marrin me vete në shkollë ilaçet e caktuara, vetëm me një letër të nënshkruar nga prindi i tyre, në të cilën duhet të tregohet qartë orari i përdorimit dhe doza e ilaçit.

Nxënësit që vuajnë nga astma – Nxënësit që vuajnë nga astma duhet ta mbajnë me vete inhalatorin / pompën apo pajisjet / medikamentet tjera të duhura.

Nxënësit që vuajnë nga diabeti – Nxënësit që janë të varur nga insulina, duhet ta kenë programin e tyre të trajtimit. Kjo duhet të diskutohet me prindërit dhe nxënësin, si dhe stafi relevant i shkollës duhet të informohet. Nëse mund të ketë ndonjë rast të papritur të hipoglicemisë apo ndonjë shenjë të pavetëdijës, atëherë duhet të thirret urgjentisht emergjenca dhe duhet të lajmërohen prindërit.

IV. Regjistrat mjekësorë

Mjeku i shkollës, në bashkëpunim me administratorin e shkollës, mbajnë evidentime për të gjitha rastet e problemeve shëndetësore. Ato evidentohen edhe në dosjet fizike personale, por edhe në databazën e secilit nxënës. Të gjitha hollësitë lidhur me problemet shëndetësore të nxënësve, siç janë: astma, alergjitë, diabeti, etj duhet të regjistrohen në databazën elektronike të profilit të nxënësit.